



Organization for Security and
Co-operation in Europe
Mission in Kosovo

Ftesë për shprehje interesi për seminarin “Angazhimi politik i liderëve të rinj” mbi rezolutën 2250 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara

A jeni paqe-ndërtues i ri i moshës 18 deri 29 vjeçe dhe a jeni të përkushtuar në ndërtimin e një paqeje kuptimplotë dhe pjesëmarrëse në Kosovë? A jeni të interesuar të mësoni më shumë mbi Rezolutën e KS të OKB-së 2250 për Rininë, Paqen dhe Sigurinë dhe si mund ta zbatoni atë në nivel lokal? A dëshironi të përkushtoheni në zhvillimin e strategjive që mundësojnë diskutime të mëtutjeshme me vendimmarrësit? A jeni të gatshëm të ndani kohë dhe mund për zhvillim dhe zbatim të një iniciative me njerëz të tjerë që mendojnë si ju? Nëse po, seminari **Angazhimi politik i liderëve të rinj** është për ju!

Seminari **Angazhimi politik i liderëve të rinj** synon dhe mëton nxitjen e kontributit e të rinjve në implementimin e rezolutës 2250 të KSKB. Gjatë këtij seminari:

- **Do të përfitoni njohuri** mbi adresimin e shtyllave kryesore për veprim të rezolutës së KS të OKB 2250: pjesëmarrja, mbrojtja, parandalimi, partneriteti, çangazhimi dhe riintegrimi;
- **Do të keni mundësi** të kontribuoni në zhvillimin e modaliteteve dhe fushave specifike për angazhim për promovimin e rezolutës 2250 të KS të OKB në nivel lokal;
- **Do të keni mundësi të angazhoheni** me të diplomuar të tjerë të programeve të OSBE-së, si dhe politikanë të rinj e të reja.

Seminari pritet të mbahet më **7 qershor 2018**. Për të aplikuar, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj së bashku me një letër motivimi në anglisht, shqip ose serbisht **deri më 28 maj 2018** përmes postës elektronike në adresën: aibek.zhumashukurov@osce.org.

Ju lusim ta keni parasysh që vetëm kandidatet e përzgjedhur në listë të ngushtë do të kontaktohen për intervistë.